

Datë: 2 Maj, 2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si -ARKEP*) bazuar Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me qëllim të përgatitjes së dokumentit për procedurat operacionale për bartshmërinë e numrave për parapaguesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, bën:

Shpallje të Konkursit Publik
për shërbime konsultante për përgatitje të termave të referencës për draftim të
dokumentit për procedurat operacionale të bartshmërisë së numrave për
shërbimet publike të komunikimeve elektronike bazuar në
marrëveshjen për shërbime të veçanta

Emri i Institucionit:	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Njësia Organizative:	Departamenti i komunikimeve Elektronike
Titulli i konsulentit:	Specialist për implementimin e bartshmërisë së Numrave
Numri i referencës:	087/1/18
Qëllimi i angazhimit:	Hartimi i dokumenteve teknike për implementimin e Bartshmërisë së Numrave
Pagesa:	Me marrëveshje sipas standardeve për projekte të tilla
Raporton te:	Shefi i Departamentit për Komunikime Elektronike
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	40 ditë pune
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Baza Ligjore

Rregullorja nr.33 për Bartshmërinë e Numrave për parapaguesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike (Ref. Nr.Prot.043/B/17 dt.28/06/2017; tutje referuar si - Rregullorja¹), e cila është miratuar me Vendimin nr.1027 (Ref. Nr.Prot.042/B/17)² të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (tutje referuar si -ARKEP) ka përcaktuar termat dhe kushtet, të cilat duhet të plotësohen nga operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për të ofruar mundësinë e bartshmërisë së numrit.

Kjo rregullore gjithashtu përcakton masat për të realizuar lehtë dhe shpejtë procesin e kalimit më të mirë të parapaguesit ndërrues.

Rregullorja gjithashtu ka marrë për bazë Kornizën Rregullatore të Bashkimit Evropian, respektivisht Direktivën 2002/22/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian të datës 7 Mars 2002 për shërbimet universale dhe të drejtat e përdoruesve të rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimeve Univesale), të ndryshuar me Direktivën 2009/136/EC të datës 25 Nëntor 2009.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i zbatimit të bartshmërisë së numrave nga të gjithë operatorët, të cilët ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike mobile dhe/ose fikse si dhe krijimin e kushteve më të mira për rritjen dhe mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 5 (Parimet e Përgjithshme), paragrafi 5.1.1) i Rregullores përcakton si në vijim:

Pas konsultimit publik, ARKEP përcakton specifikimet mbi ndërfaqet e përbashkëta për sinjalizim, përshkrimin e arkitekturës së rrjetit, procedurat operacionale në përputhje me Kapitullin III të kësaj Rregulloreje dhe marrëveshjet mbi nivelin e shërbimeve. Arkitektura e sinjalizimit dhe rrjetit do të bazohet në specifikacionet e ETSI-it.

Po ashtu neni 15 (Fillimi i zbatimit të Bartshmërisë së Numrave), paragrafët 15.1) dhe 15.2) të Rregullores përcaktojnë si në vijim:

15.1 Bartshmëria e numrave për parapaguesit e telefonisë fikse do të fillohet të zbatohet pas hartimit të dokumentit/eve me specifikimet e nevojshme teknike të bazuara në standardet e ETSI të miratuar nga ARKEP.

15.2 Bartshmëria e numrave për parapaguesit e telefonisë mobile do të fillojë të zbatohet pas hartimit të dokumentit/eve me specifikimet e nevojshme teknike të bazuara në standardet e ETSI të miratuar nga ARKEP dhe implementimit të Projektit për Bartshmërinë e Numrave.

¹ <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,34,1007>

² <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,26,1008>

Më tutje neni 7 i Rregullores përcakton se Baza Qendrore Referuese e të dhënave (CRDB)³ do të menaxhohet nga ARKEP.

Qëllimi i angazhimit të Konsulencës

Qëllimi i angazhimit të konsulencës është hartimi i dokumentit/ve të parapara në Rregulloren për Bartshmërinë e numrave të ARKEP si dhe Standardet e ETSI.

Konsulenti gjatë hartimit të dokumentit teknik, përkatësisht procedurat operacionale:

1. Gjatë tërë procesit të hartimit të dokumentacionit konsulencia duhet të njoftoj stafin profesional të ARKEP në mënyrë periodike për procesin e zhvilluar (hapat e realizuar) dhe mundësia e hapur e komunikimit të stafit profesional me ekspertët e konsulencës, duke përfshirë edhe përgjigje në kërkesa sqaruese sipas nevojës.
2. Në fund duhet të hartohet një Raport përfundimtar lidhur me procesin e hartimit të dokumentacionit teknik, duke specifikuar në mënyrë të detajuar metodologjinë e aplikuar me sqarimet përkatëse për të gjitha kriteret e aplikuar.
3. Në kuadër të hartimit të dokumentacionit do të organizohen takime me operatorët, të cilët ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike mobile dhe fikse;

Kërkesat Specifike

Detyrat dhe përgjegjësitë duhet të jenë si në vijim:

- 1) Në përputhje me Kërkesat e Rregullores për Bartshmërinë e Numrave, Standardet e ETSI⁴, si dhe praktikat e Rregullatorëve nga vendet tjera europiane dhe më gjërë të hartoj dokumentin lidhur me specifikimet mbi ndërfaqet e përbashkëta për sinjalizim, përshkrimin e arkitekturës së rrjetit, procedurat operacionale dhe marrëveshjet mbi nivelin e shërbimeve;
- 2) Arkitektura e sinjalizimit dhe rrjetit duhet të bazohet në specifikacionet e ETSI;
- 3) Përcakton specifikimet teknike harduerike dhe softuerike lidhur me implementimin e projektit për bartshmërinë e numrave;
- 4) Analizon tregun e komunikimeve elektronike me fokus në shërbimet mobile dhe fikse të komunikimeve elektronike, si dhe të dhënat e dërguara nga operatorët dhe palët tjera të interesit lidhur me propozimet e tyre për funksionimin e CRDB;

³ **Baza Qendrore Referuese e të Dhënave (CRDB)** – është një bazë e të dhënave, e cila ruan gjendjen e secilit transaksion gjatë procedurës së bartjes së numrit dhe përmban informatat e nevojshme për rrugëtimin e thirrjes në drejtim të numrit të bartur. Të gjitha këto informata përditësohen në kohë reale edhe për bazat lokale të operatorëve.

⁴ European Telecommunications Standard Institute

- 5) Në hartimin e dokumentit duhet të analizohen dhe merren parasyshë edhe dokumentet tjera të CEPT/ECC.
- 6) Afati i angazhimit max 40 ditë pune.

Kriteret e kualifikimit

Kriteret e kualifikimit si në vijim:

- 1) Së paku 10 vjet përvojë në zhvillimin e softuerëve, përfshirë përvojën në udhëheqjen e zhvillimit të softuerëve kompleks për sisteme të ndryshme;
- 2) Të ketë përvojë në zhvillimin e së paku një sistemi të Bartshmërisë së Numrave në rrjetet Mobile (Mobile Number Portability) ose Fikse (Fixed Number Portability);
- 3) Përvojë pune në aplikacionet për zhvillim të softuerëve.

Aplikatat duhet të dërgojnë prova që përmbushin kriteret e mësipërme, nëpërmjet CV së tyre dhe referencave specifike për të gjitha projektet pjesëmarrëse, me email në adresën e mëposhtëme: info@arkep-rks.org me subjekt: Number Portability Expertise

Afati i aplikimit është 14th Maj 2018, 16:00 CET.